

Shpallet 1 pozicion pune pranë Qendrës së Pritjes për Azil (QPA) – Afatet, dokumentacioni

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19 pika 1, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”; të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Qendra e Pritjes për Azil (QPA) shpall 1 vend vacant me kontratë të përhershme:

1. Kuzhinier- Klasa e pagës V

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Përgatitja e ushqimit për azilkërkuesit sipas standarteve të caktuara.

DETYRAT KRYESORE

- a) Përgatit në bashkëpunim me Sektorin e Mbështetjes së Azilkërkuesve, menunë ditore.
- b) Përgatit dhe shpërndan ushqimin në kohën e përcaktuar sipas rregullave të përcaktuara, duke respektuar cilësinë, sasinë dhe kaloritë e miratuara.
- c) Rakordon punën me magazinën dhe specialistin e burimeve njerëzore për zbatimin e menusë ditore.
- d) Tërheq produktet ushqimore nga magazina.
- e) Shërben të gjitha vaktet ndaj azilkërkuesve, duke respektuar etikën e komunikimit me azilkërkuesit si dhe duke patur një paraqitje të përshtatshme me uniformat që ka siguruar qendra.
- f) Ruan kampionin e çdo vakti në frigorifer
- g) Pastron ambientin e kuzhinës dhe pajisjeve brenda saj.

h) Kryen detyra të tjera të caktuara nga titullari i institucionit, që nuk janë në kundërshtim me ligjet dhe nuk çënojnë dinjitetin e punonjësit.

Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët për këtë pozicion:

Arsimi: I ulet.

Përvoja: Përvojë pune.

Tjetër: Aftësi për të organizuar punën në mënyre komplet autonome, duke përcaktuar përparësitë, marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse dhe respektuar limitet e caktuara. Aftësi për t'u adaptuar në ambiente dhe kultura të ndryshme pune, fleksibile dhe aftësi për vetë iniciativë.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të aplikimeve

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet:

1. CV dhe Letër motivimi;
2. Diplome e Shkollës 8-vjecare të noterizuar së bashku me listë notash;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
7. Dëshmi Penaliteti;

Mos dorëzimi i dokumentave të mësipërme dhe mosplotësimi i kriterëve, e skualifikojnë automatikisht aplikantin.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës **12.02.2024 ora 10:00**, në rrugë zyrtare ose dorazi në protokollin e Qendrës së Pritjes për Azil, me adresë Rr. “Myslym Keta”, Babrru, Tiranë.

Zhvillimi i intervistës me aplikantët e përzgjedhur nga komisioni “Ad-hoc” **brenda datës 13 Shkurt 2024 ora 11:00** si dhe njoftimi i kandidatit të suksesshëm **brenda datës 13 Shkurt 2024**. **Vetëm kandidatët të cilët përmbushin kriteret do të përzgjidhen dhe do të njoftohen për intervistë pranë Qendrës së Pritjes për Azil.** Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.